



BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

JANAR 2025

BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

JANAR 2025

**Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet e ZKPSH-së për muajin JANAR 2025**

U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Kryesuesi i KPK-së dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale vizitojnë Prokurorinë Themelore në Pejë

Pejë, 15 janar 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Blerim Isufaj, kanë zhvilluar vizitë zyrtare në Prokurorinë Themelore në Pejë ku janë pritur në takim nga Kryeprokurorja e kësaj prokurorie, znj. Lumturije Vuçetaj.

Krerët e sistemit prokurorial kanë uruar znj. Vuçetaj për zgjedhjen e saj në krye të Prokurorisë Themelore në Pejë, ku gjatë këtij takimi ata kanë pasur diskutime të frytshme për çështje të ndryshme profesionale, duke i ofruar asaj mbështetje dhe përkrahje të plotë në arritjen e objektivave.



Gjithashtu, ata kanë shprehur vullnetin e tyre institucional që brenda mandatit dhe kompetencave ligjore të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë ngushtë dhe në mënyrë efektive me Prokurorinë Themelore në Pejë dhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

Ndërkaq, Kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore të Pejë, znj. Lumturije Vuçetaj, falënderoi krerët e sistemit prokurorial për vizitën, mbështetjen dhe përkrahjen e ofruar si dhe u zotua që bashkërisht do bëjnë më të mirën e

mundshme për sundimin e ligjit dhe arritjen e objektivave të parapara në planin e punës në mandatin e saj katër vjeçar.

Prokurori i Shtetit është angazhuar në mbrojtjen e votës së lirë për qytetarët e Kosovës

Prishtinë, 16 janar 2025 – Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit informon opinionin publik se Prokurori i Shtetit ka filluar angazhimin në mbrojtjen e votës së lirë për qytetarët e Republikës së Kosovës, për zgjedhjet nacionale që do të mbahen më 9 shkurt 2025.



Në kuadër të këtij angazhimi dhe pas pranimit të informatave se ka raste të dyshuara në drejtim të veprës penale „Cenimi i fshehtësisë së votimit”, nga neni 215 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka autorizuar Policinë e Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme hetimore.

Prokurori i Shtetit do të ndalojnë çdo qytetarë që në çfarëdo mënyre do të tentojnë apo ndikojnë në keqpërdorimin e votës së lirë të sovranit dhe fton qytetarët që të bashkëpunojnë me Prokurorin e Shtetit, duke i përcjellë në prokurori informatat që kanë lidhur me keqpërdorimin e votës së lirë të sovranit.

Mbahet takimi i radhës për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027

Prishtinë, 16 janar 2024 – Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), përkatësisht anëtarët e Grupit punues për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027, të udhëhequr nga Zëvendësja e Kryesuesit të KPK-së, znj. Jehona Grantolli, mbajti një takim për të vlerësuar ecurinë e hartimit të tij, i cili mbështetet nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhe Zyrës së BE-së.

Më këtë rast, znj. Jehona Grantolli, falënderoi grupin punues dhe partnerët ndërkombëtarë për ndihmën e ofruar në hartimin e draftit bazik, sidomos Ambasadën Amerikane, duke theksuar se janë pajtuar për t'i trajtuar objektivat e caktuar strategjike në brendësinë e këtij drafti dhe çështjet e identifikuar për veprimtarinë trevjeçare të sistemit prokurorial.

Edhe Kryesuesi i KPK-së, z. Ardian Hajdaraj dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, gjatë fjalës së tyre, nënvizuan rëndësinë e madhe të Planit strategjik, duke kërkuar që të dalin në pah vlerat e tij, të cilat kanë të bëjnë me profesionalizmin, integritetin, etikën dhe pavarësinë në punë të sistemit prokurorial.



Në përfundim të takimit të sotëm, u tha që së bashku me përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë do të mbahen takime të tjera gjër në finalizimin e këtij plani, i cili do të jetë në mbështetje të sundimit të ligjit, ruajtjes së pavarësisë, forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit mbajti takimin e kolegjiut me kryeprokurorët e të gjitha prokurorive

Prishtinë, 21 janar 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjiut e rregullt me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive të vendit dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku kanë marrë pjesë edhe prokurori për çështje kibernetike në Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së, z. Nathan Brooks si dhe përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë.



Gjatë këtij takimi, kryeprokurorët dhe prokurorët e ZKPSH-së patën një diskutim të hapur dhe përmbajtësor me z. Brooks, për tema që ndërlidhen me krimet kibernetike, me ç'rast u shkëmbyen përvojat profesionale nga kjo fushë.



Çështje tjetër me rëndësi që u diskutua në këtë takim ishte edhe numri i rasteve me kryerës të panjohur të veprave penale. Lidhur me këtë pati diskutime për gjetjen e një zgjidhje që do të ndikonte në zvogëlimin e numrit të këtyre rasteve, duke përfshirë edhe shtimin e kërkesave për Policinë e Kosovës që të angazhohet më shumë

për zbulimin dhe identifikimin e këtyre kryerësve të veprave penale.

Po ashtu, në këtë takim u diskutua edhe për Planin e Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2025, i cili plan do të jetë në harmoni me strategjinë e sistemit prokurorial.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit kërkon nga kryeprokurorët e prokurorive angazhim në mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 21 janar 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi së bashku me Koordinatorin Nacional për Zgjedhje, prokuroren nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula, kanë mbajtur takim me kryeprokurorët e të gjitha prokurorive në vend ku të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Kosovë si dhe Menaxheri i projektit strategjik “Mbrojtja e votës”, në kuadër të sistemit prokurorial, z. Besim Kusari.

Në këtë takim, U.D. Kryeprokurori Kelmendi kërkoj nga Koordinatorja Nationale për Zgjedhje, znj. Pula dhe kryeprokurorët e prokurorive angazhim të shtuar lidhur me mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës për zgjedhjet nacionale që do të mbahen më 9 shkurt 2025.



Po ashtu gjatë këtij takimi u diskutua për koordinimin në mes të prokurorive dhe Koordinatorës Nationale lidhur me të gjitha

aktivitetet e Prokurorit të Shtetit që do të ndërmerren në rast se do të ketë cenim të procesit zgjedhor, si dhe duke përfshirë edhe bashkëpunimin e ngushtë me institucionet tjera ligjzbatuese në veçanti me Policinë e Kosovës.

Në këtë takim të pranishmit u informuan nga Koordinatorja znj. Pula, se pas pranimi të informatave lidhur me dy raste të dyshuara në drejtim të veprës penale „Cenimi i fshehtësisë së votimit”, nga neni 215 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prokuroria Themelore në Prishtinë është duke i zhvilluar hetimet.

Në këtë takim u ritheksua se Prokurori i Shtetit do të vazhdojë të trajtojë secilin rast me urgjencë dhe brenda afateve ligjore.

Prokurori i Shtetit fton qytetarët të cilët kanë apo mund të kenë informata se në çfarëdo mënyre po cenohet fshehtësia e votës apo çfarëdo veprimi tjetër i ndërmarrë që bie në kuadër të veprave penale kundër të drejtës së votimit, t'i raportojnë ato tek Prokurori i Shtetit apo tek Policia e Kosovës.

Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje nga sistemi prokurorial u takua me përfaqësues të Misionit Vëzhgues për Zgjedhje nga Bashkimi Evropian

Prishtinë, 23 janar 2025 – Përfaqësues të Misionit Vëzhgues për Zgjedhje nga Bashkimi Evropian, kryesuar nga analistja ligjore e këtij misioni, znj. Eirini Skouzou, vizituan sot Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ku u pritën në takim nga Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, prokurorja nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula.

Gjatë këtij takimi u diskutua për rrjedhën e procesit zgjedhor për zgjedhjet nacionale në vendin tonë, që do të mbahen më 9 shkurt 2025 e me theks të veçantë u diskutua për planin operativ të Prokurorit të Shtetit në ditën e zgjedhjeve.



Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, znj. Pula informoi të pranishmit për angazhimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës për zgjedhjet nacionale që do të mbahen më 9 shkurt 2025.

Po ashtu gjatë këtij takimi u diskutua për koordinimin në mes të prokurorive dhe Koordinatorës Nacionale lidhur me të gjitha aktivitetet e Prokurorit të Shtetit që do të ndërmerren në rast se do të ketë cenim të procesit zgjedhor, si dhe duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërinstitucional në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit për procesin zgjedhor, në mes të institucioneve që merren me administrimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e rasteve zgjedhore.

Ndërkaq, përfaqësuesit e Misionit Vëzhgues për Zgjedhje nga Bashkimi Evropian, informuan për angazhimin e vëzhguesve ndërkombëtarë në kuadër të këtij Misioni, për rolin e tyre dhe shpërndarjen e tyre në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Mbahet Takimi i 261-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 23 janar 2025 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit mori pjesë në takimin e 261 të Këshillit Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, me ç'rast fillimisht z. Hajdaraj uroi kryeprokurorët e rinj për zgjedhjen e tyre në krye të prokurorive të vendit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit

të ndërsjellë për të zbatuar objektivat e përbashkëta.



Vendimet që mori KPK-ja në takimin e sotëm janë si vijojnë:

- Miratoi në tërësi Raportin e punës së Prokurorisë së Apelit për vitin 2024, kurse për raportet vjetore të punës së Prokurorisë Speciale, Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në Ferizaj, në Pejë, në Gjiilan dhe në Mitrovicë obligoi kryeprokurorët përkatës që në afat prej shtatë (7) ditësh të plotësojnë raportet përmbledhëse me statistikën e raporteve individuale të prokurorëve dhe realizimin e normave të tyre orientuese, kurse Prokurorinë Themelore në Prizren e obligoi që të plotësojë raportin përmbledhës me numrin e rasteve të procedurave për konfiskim të aseteve të fituara me vepra penale, si dhe të njëjtat raporte t'i dorëzojnë në Zyrën e Kryesuesit të KPK-së dhe
- Anëtarët e KPK-së u njoftuan nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit për Planin e Personelit Administrativ për vitin 2025.

U.D. Kryeprokurori Kelmendi mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së 61-të të kadetëve të Policisë së Kosovës

Prishtinë, 24 Janar 2025 – Me rastin e diplomimit të gjeneratës së 61-të të kadetëve të Policisë së Kosovës, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në

ceremoninë e diplomimit të policëve të rinj që është organizuar nga Policia e Kosovës.

